



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 8983 Prot.

Tiranë, më 31.08. 2018

Lënda: Për trajtimin e kërkesave lidhur me rivlerësimin e diplomave të lëshuara në përfundim të programit të studimit “Infermieri e përgjithshme”, me kohëzgjatje 3.5 vite akademike.

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Tiranë

Për dijeni: **Universitetit të Mjekësisë,**

Tiranë

Lidhur me rivlerësimin e nivelit të kompetencave, njohurive dhe diplomës së lëshuar në përfundim të programit të studimit “Infermieri e përgjithshme”, me kohëzgjatje 3.5 vite akademike nga ish Shkolla e Lartë e Infermierisë, (sot Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit të Mjekësisë së Tiranës), Ju informojmë se;

Universiteti i Mjekësisë të Tiranës, me qëllim njohjen dhe vlerësimin e objektivave formuese, njohurive, kompetencave profesionale dhe akademike të studentëve, si dhe përputhshmërinë e njohurive dhe kompetencave të këtij programi studimi me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, me urdhrin e Rektorit nr. 46, datë 06.07.2018, ka ngritur Grupin e punës “Për shqyrtimin e kërkesës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë lidhur me kurrikulën e programit të studimit “Infermieri e përgjithshme”, me kohëzgjatje 3.5 vite akademike”,

Grupi i punës, në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të sa më sipër, përmes Raportit Informues nr. 1601/2 prot, datë 10.07.2018 “Për programin e studimit “Infermieri e përgjithshme”, me kohëzgjatje 3.5 vite akademike”(bashkëlidhur), ka vlerësuar se Programi i Studimit “Infermieri e përgjithshme”, me kohëzgjatje 3.5 vite akademike, ofruar nga ish Shkolla e Lartë e Infermierisë, (sot Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit të Mjekësisë së Tiranës), është ekuivalent me “Master i Shkencave”.

Ju faleminderit,



MINISTËR
LINDITA NIKOLLA